

SHADAN RAMADANI

DEZERTIMI SI MOTIV LETRAR NË VEPRAT E ALFRED ANDERSCH-IT

398.87(=18):2-264

Abstract: In this paper it will be tried to break down this complex and important subject in literature. On one side, certain works of Alfred Andersch will be scrutinized to the importance of the element of the deserter as a literary motive and on the other side, the autobiographic events which have to do something with the motive will be briefly described.

Furthermore, there will be efforts to show some light about the desertion as a literary motive, which took an important place in the process of the authors creativity.

There is always a question to be asked and that question is, if the personal developments of Alfred Andersch are main reasons that he, in many cases in his works, reflects the events in form of the deserter. That is why I will try to describe a part of his biography, which not only is full of occurrences of his personal and turbulent life, but also, without any doubt, has a very literary reflection.

With this paper, we intend to give a special contribution to the area of studies in german literature and at the same time, to serve as a guide in studies and researches, which will be made in the future in this area. This scientific deliberation will show the literary creation that will be based on descriptive, analytical and comparative methods.

Key words: Language, Culture, Literature, Creation, Desertion

1. ALFRED ANDERSCH

Gjithmonë do të shtrohet hipoteza, nëse zhvillimet personale të Alfred Andersch-it janë shkaqe kryesore që ai në veprat e tij shumë raste dhe ngjarje i pasqyron në formë të arratisjes (dezertorit). Ndaj do të përpinqem që më poshtë të përshkruaj një pjesë të biografisë së tij, e cila jo vetëm që është shumë e pasur me ngjarje nga jeta private turbulente por edhe nga krijimtaria e tij e cila ka një rëndësi të madhe letrare.

1. 1 JETA E AUTORIT

1. 1. 1 RINIA E TIJ

Alfred Andersch ka lindur në 4 shkurt 1914 në Mynih dhe ishte fëmija i dytë nga tre sa ishin. Ai kishte marrëdhënie më të mira më nënën Hedwig Andersch se sa ndaj babit (Alfred Andersch seniori), i cili si veteran i luftës së parë botërorë njihej edhe si nationalist i rreptë. Andersch-i ka ndjekur gjimnazin Wittelsbach në Mynih. Shkolla udhëhiqej atë kohë nga Joseph Gerhard Himmler-i, dhe gjatë asaj periudhe instituti ishte nën ndikimin e udhëheqësit të SS-it dhe shefit të policisë gjermane. Këtë ngjarje Andersch do ta përshkruajë në formë letrare pak para vdekjes së tij në vitin 1980 në tregimin e tij *Der Vater eines Mörders*¹, i cili ishte i angazhuar në kohën e rinisë në gjimnazin Wittelsbacher. Ka pasur disa lexues, të cilët kanë qenë dëshmitarë të drejtpërdrejtë të asaj kohe dhe e kanë njojur drejtorin duke e parë me një sy tjetër respektivisht si viktimi, ndryshtë nga ajo se si e përshkruan autori. Që në rini Andersch

¹Krh.Walden, Niço: Jahresarbit über den Schriftsteller Alfred Andersch. Në:
<http://www.schultreff.de/biographien/b0005t00.htm>. Online 23.02.2017.

interesohej më shumë për letërsinë se sa për shkollën, duke bërë që ky interesim ta largojë atë nga gjimnazi në moshën 14 vjeçare, dhe duke i dhënë një arsyebabait që ti gjejë punë si artizanat në një librari. Siç e përshkruan edhe vetë autor i veprën e tij *Kirschen der Freiheit*, ai largohet shpesh nga rrethi i ngushtë dhe si i shtypur social që ishte në shtëpinë e tij, ai vazhdonte duke bërë xhiro me bicikletë.¹

Pas vdekjes së babait të tij Andersch gjendet në një situatë të vështirë, duke e rënduar dhe fakti që ishte i papunë. Kjo ishte një arsyeb se përsë ai iu bashkëngjit shoqatës së rinisë së partisë komuniste duke e parë si një mundësi për të dalë nga ajo situatë e vështirë, duke u bërë shumë shpejt udhëheqës i asaj organizate. Kjo punë për autorin është një punë e re, e panjohur dhe e shumëpritur prej vitesh. Ai lulëzon dhe i afrohet me shumë seriozitet teorisë komuniste duke i bërë mësuesit e tij të vjetër shumë të kënaqur me entuziazmin e tij.²

1. 1. 2 LUFTA DHE KOHA – NS³

Kur erdhën nacional-socialistët 1933 në pushtet Andersch si komunist që ishte, arrestohet menjëherë dhe dërgohet në kampin Dachau. Vetëm me përpjekjet e një shoku të familjes ai arrin të lirohet pas tre muajve. Ai nuk lejon që kjo ngjarje ti ndryshojë rrjedhën e përditshmërisë, duke marrë vendimin të kthehet prapë në parti, duke u bërë shkak për arrestimin e tij të dytë. Në momentet kur ai merrej në pyetje, dëgjon dhe kuption se si trajtohen të arrestuarit në Dachau. Me këtë rast tek ai krijohet një lloj frike dhe paniku se mund te internohet, por përfatim e tij të mirë ai lirohet pikërisht në atë ditë. Pas këtyre përvjave të hidhura ai vendos që mos të punojë më për komunistët. Në vitin 1935 ai martohet me Angelik-ën e cila ishte gjysmë hebreje. Atyre u lind një vajzë dhe zhvendosen në Hamburg, ku Andersch fillon të punojë në një shtëpi botuese. Ndërkohë jeta martesore e tyre ngadalë shuhet dhe Andersch dashurohet në piktoren Gisela Gronauer, me të cilën ndërmjet periudhës 1940 dhe 1945 u lindin dy djem. Në vitin 1940 Andersch gjendet si ushtar në Francë por për arsyeb se ai kishte qenë i burgosur në kampin koncentrues ai lirohet përsëri nga shërbimi ushtarak. Pas martesës së tij me zonjën Angelika ai ndahet nga ajo dhe në vitin 1943 shkurorëzohet para kohe, më arsyeb kryesore, fitimin e të drejtës për të botuar. Po në këtë periudhë depërtohet vjehrëra e tij dhe bie viktimit e Holokaustit. Në vijim ai detyrohet përsëri vitin 1943 të ndjek shërbimin ushtarak, ku në verën e vitit 1944 merr qëndrim përfundimtar dhe arratiset nga shërbimi ushtarak.⁴ Pas arratisjes së tij dhe dorëzimit ai dërgohet në SHBA ku u bashkëngjitet atyre që ndajnë të njëjtin mendim. Ai përjeton një pranverë të dytë, njëlloj sikurse iu bashkëngjit shoqatës rinisë komuniste, e cila e ndoqi në gjithë karrierën e tij. Ai ka shkruar për magazinën *Der Ruf / Thirrja*, revistë e cila përkujdesej përgjendjen e të burgosurve. Pas gati një viti në arrestin Amerikan, ai lirohet 1945 dhe dërgohet përsëri në Europë.

1. 1. 3 KTHIMI NË GJERMANI

Pas rikthimit në Gjermani në vitin 1945 Andersch punon si redaktor në gazeten *Neue Zeitung / Gazeta e re* në Mynih.⁵ Aty ai e kuption shumë shpejt se pikëpamjet e tij nuk përpushten me linjat e gazetës, andaj dhe ky vend pune është një zgjidhje kalimtare. Edhe pse ai kishte mundësinë që nëpërmjet udhëheqësit të tij Erich Kästner të zhvillohet më tej në fushën e gazetarisë, ai mori një hap tjeter pas takimit me kolegët

¹Krh. Andersch, Alfred (1952): Die Kirschen der Freiheit. Zürich. F. 31-32.

²Krh. Po aty. F. 25.

³Nacionalsozializmi

⁴Krh. Andersch, Alfred. Në: https://de.wikipedia.org/wiki/Alfred_Andersch. Online: 1.03.2017.

⁵Krh. Andersch, Alfred. Në: https://de.wikipedia.org/wiki/Alfred_Andersch. Online: 1.03.2017.

gazetarë të mëhershëm duke botuar një gazetë të re e quajtur *Der Ruf*.¹ Kjo gazetë ndjek një kurs të lirë dhe demokratik dhe së shpejti do njihet si një gazetë prestigjioze dhe vërtet e lirë. Për shkak se Anderschi dhe Richter nuk ishin qartë të pozicionuar në anën e amerikanëve por përkundrazi ata anonin drejt pozicionit të së majtës, atyre u merret e drejta e redaktimit. Megjithëse redaktorët, të cilët kishin njohuri mbi socializmin ose ishin të njohur si bashkëluftëtarë nazist, përsëri ata nga viti 1947 nuk censurohen nga amerikanët. Por me suksesin e madh të reputacionit Andersch-i dhe Richter-i ndjeheshin të forcuar andaj nuk donin të hiqnin dorë për të krijuar një gazetë të re të lirë. Megjithëse ky projekt dështon, përsëri konferanca e parë e redaksisë përcjell impulset për krijimin e grupit 47, që njihet si shoqatë shumë e rëndësishme e shkrimitarëve të gjermanëve pasluftës. Anderchi fillon paralelisht edhe më fuqishëm të interesohet për filozofin ekzistenciale, e cila menjëherë pas luftës së dytë botërore u popullarizua shumë. Viteve pas luftës egzistencialistët kërkonin më shumë përkrahje dhe liri individuale.² Mes viteteve 1947 dhe 1957 Andersch punoi intensivisht në Frankfurt am Main, Hamburg dhe Stuttgart për radio projekte të cilat ishin të orientuara për kultura të ndryshme. Para se të heq dorë Andersch nga pozitat zyrtare në vitin 1957, ai krijon edhe revistën *Texte und Zeichen*, në të cilën angazhon si zëdhënës shumë autorë të panjohur³. Në këtë revistë shfaqen edhe shumë autorë tjerë të cilët nuk njiheshin më parë dhe as nuk kishin mundësinë për të publikuar idetë e tyre. Edhe pse kjo për autorin ishte një zgjidhje e përkohshme, ai fitoi përvjetorë të madhe dhe në vitin 1956 ai boton me një sukses të madh romanin e tij të parë *Sansibar oder der letzte Grund*. Dhe më pas kur ai e sheh se edhe si shkrimitari i lirë mund ta mirëmbajë familjen e tij, ai zhvendoset në Tassin të Zvicrës.

1.1.4 JETA NË ZVICRË

Në vitet e fundit të qëndrimit të tij në Gjermani autorin përveç ngarkesës fizike të tepërt në angazhimi i tij paralel në shumë projekte, e preokuponte gjithashtu edhe puna e tij gazetareske, që e shihte si jo efektive dhe zhgënjesë. Andersch përpinqej që veprimitaria e tij letrare të mos jetë kalimtare dhe sipërfaqësore sikurse kontributi i tij në gazetari. Në vitin 1957 autorit së bashku me familjen e tij vendoset në fshatin Berzona të Zvicrës dhe aty ka për komshi Max Frisch-in dhe Golo Mann⁴. Në këtë atmosferë stimuluese ai boton romanin e tij të dytë *Die Rote* dhe më pas në vitin 1967 vazhdon me botimin e tij më të suksesshëm të veprës *Efraim*⁵. Për këtë veprimitari atij i ndahet çmimi *Nelly Sachs*⁶. Pas botimit të romanit të radhës *Winterspelt* në vitin 1974 ai sëmuret me herpes. Edhe pse e përballon dhe tejkalon këtë sëmundje ai në vitin 1977 vuan nga një sëmundje e rëndë e veshkave. Pak para vdekjes së tij në shkurt të vitit 1980 ai arrin ta përfundojë tregimin *Der Vater eines Mörders* ku rrëfen për periudhën e tij në gjimnazin Wittelsbach në Munyh, ku drejtori i shkollës ishte Heinrich Himmler.⁷

¹Krh. Andersch, Alfred. Në: https://de.wikipedia.org/wiki/Alfred_Andersch. Online: 1.03.2017.

²Krh. Koppermann, Ulrike (2013): Baßhelorarbeit: Zu Engagement und Vergangenheitsverdrängung in Alfred Anderschs Literaturprogramm und seinem Roman *Die Rote*. Potsdam. F. 14.

³Krh. Schön, Karl (2013): Alfred Andersch und seine Zeitschrift „Texte und Zeichen“. München. F.4-10.

⁴Krh. Conrad, Bernadette: Zeit Online. Sein letztes Refigium. Në: <http://www.zeit.de/2011/20/Max-Frisch-Berzona>. Online 05.03.2017.

⁵Krh. Jahresarbit über den Schriftsteller Alfred Andersch. Në: <http://www.studentshelp.de/p/referate/02/6482.htm>. Online 05.03.2017.

⁶ Nelly Sachs Çmimështenjëçmim per veprimitari letrare dhe ndahet çdo dy vite nga qyteti i Dortmund.

⁷Krh. Conrad, Bernadette: Zeit Online. Sein letztes Refigium. Në: <http://www.zeit.de/2011/20/Max-Frisch-Berzona>. Online 05.03.2017.

1. 1. 5 DEZERTIMET NË JETËN E AUTORIT

Nga biografia e Alfred Andersch të përshkruar më sipër mund të lexohen disa raste të lëvizjes dhe arratisjes së tij, nga e cila mund të supozohet, se ishin edhe nxitje, që ai shumë shpesh i shfaq në veprat e tij si motiv arratisjeje. Kjo gjë duket më qartë kur ai arratiset nga ushtria në vitin 1944, por edhe turnet me bïçikletë në periudhën e rinisë së tij kur ai duhej të ikte nga babai i tij, me të çilin ishte në konfrontim politik, gjithashtu edhe kyçja e tij në shoqatën komuniste të rinisë duke u shfaqur si situata të vogla arratisjeje. Fakti i pakënaqësisë së tij në Gjermani dhe vendimi që të drejtobhet në Zvicër mund të merret si një motiv i rëndësishëm arratisjeje. Këtë çështje do të mundohem ta shqyrtoj dhe shtroj në kapitullin vijues.

2. DEZERTIMI SI MOTIV LETRAR NË KRIJIMTARINË E AUTORIT

Në këtë kapitull do të bëhet përpjekje, që në veprat e përzgjedhura të Alfred Andersch-it nga njëra anë të shqyrtohet rëndësia e elementit të dezertorit si motiv letrar dhe nga ana tjetër do të përshkruhen të gjitha ngjarjet autobiografike që kanë të bëjnë me këtë motiv.

Më tej do të bëhet përpjekje që të hidhet dritë mbi dezertorin si motiv letrar, që ka zënë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij.

2. 1 SANSIBAR ODER DER LETZTE GRUND¹

Në këtë roman, ngjarje e cila zhvillohet pak para luftës së dytë botërore gjérësish në vitin 1937², Andersch përshkruan përplasjen e rëndësishme të pesë njerëzve nga fshati Rerik afër detit baltik. Gjatë tregimit secili prej tyre në jetën iu janë nënshtuar një situate thelbësore dezertimi, ose e ka lënë këtë pas vete, kështu si Fischer Knudsen, i cili është ankoruar po në këtë fshat. Ai ka ndërrprerë para shumë kohe pjesëmarrjen e tij aktive brenda Partisë Komuniste dhe do të bindet nga një shok i tij për një takim të fundit me një instruktor të komitetit qendror KPD³. Para se të vij deri më këtë takim, ai ja del që nëpërmjet një pastori kishtar të zhgënjer dhe një kërkësë me lutje ndaj Fischer Knudsen-it, të arrijë që të kontrabandojë një punim artistik të ndaluar nga nazistët në Suedi. Kjo rrëfen periudhën e vështirë me të cilën do të përballet vendi. Në të njëjtën kohë arrin në Rerik edhe çifutja e re dhe e pa përvojë Judith, e çila gjithashtu dëshiron që me kohën nëpërmjet rrugëve detare të kalojë në një vend të sigurt. Udhërrëfyes në tregim është djali i ri i anijes së Knudsen-it, i cili në shumë raste përballet me katër aktorë të tjerë vetëm si përcjellës në heshtje dhe nuk e fsheh përballet tyre se edhe ai dëshiron të largohet, pasi se ai nuk mund të qëndroje më në atë vend. Kjo qëndron për arsyen se Fischer Knudsen-i i sjell gjithashtu edhe figurat nga druri „[s]ie waren aus Holz geschnitzt, ... / ata/o ishin prej drurit të gdhendur, ...“⁴ jashtë vendit. Por kur ai kupton se edhe komunisti Gregor dëshiron të udhëtoje me ta, ndjehet i shfrytëzuar. Skena dramatike finale fillon me kalimin e Knudsen-it dhe djalit të anijeve të tij për në Suedi. Në anije janë Judith-i dhe figurat e drurit të gdhendur të kishës. Gregor-i është vonuar andaj dhe vendos të vazhdojë rrugëtimin vetëm. Një situatë që tregon qartë që njeriu duhet të marr çështjet personale në duart e tij. Pastori Helander përgatitet për herë të fundit kundër botës, ku ai gjuan kundër njerëzve të gestapos, të cilët në këtë ditë duhej të marrin figurat e drurit. Libri përfundon me përshkrimin që djali u tërroq, pasiqë largimi i tij dukej i kapshëm gjatë udhëtimit. Një motiv i qartë është me siguri ikja nga Judith, ku

¹Andersch, Alfred (1957): Sansibar oder der letzte Grund. Olten.

²Andersch, Alfred (2003): Sansibar oder der letzte Grund. St. Gallen. Në:

<http://www.romanlooser.ch/Façharbeit/FaçharbeitBeispiel.pdf>. Online 14.02.2017

³ KPD: Partiakomuniste e Gjermanisë.

⁴Andersch, Alfred (1970): Sansibar oder der letzte Grund. Zürich. F. 42.

ajo nuk ndjehet më e sigurt ne Gjermani, e cila është me rëndësi jetike për te dhe duhet të lëshojë vendin sa më shpejt që është e mundur.

Gjithashtu shihen dy komunistë qe nuk duan të kenë asgjë me partinë e tyre, ku njëri është larguar tanimë dhe tjetri është gati të ndjek atë rrugë.¹ Një situatë ku rrëfyesi qartë shpreh qëndrimin e tij me motiv arratisës. Kjo na tregon se në çfarë gjendje ka qenë autorë.

Në anën tjetër makthi thelbësor i Pastorit Helander rezulton nga humbja e besimit të tij në një Zot, veprimet e të cilët nazistët e vështrojnë nëpërmjet gishtave. Edhe pse Helander qenë strehë dhe ka kuptim jeta e tij me veprintarinë autonome gjatë ruajtjes së figurave drurit përsëri nuk i shpëton vdekjes, mbasë ai nuk mund të durojë prezencën e Zotit te tij. Këtu vërehet qartë se një dezertim i tillë nga Camus-i nga pikëpamjaekzistenciale është një marrëzi absolute. Camus pohon qartë se as vetëvrasja e as arratisja si një lloj ideologjie nuk mund të përfaqësoje një mënyrë për të dale nga kotësia e jetës². Djali ndjehet i kufizuar nga shoqëria dhe nuk arrin, që të dalë nga rrathi i po asaj shoqërie. Ai dëshiron më në fund të marrë jetën në duart e tij dhe kështu bën lëvizje të qartë filozofike sipas teorisë së Thugenhat Ernst-it *Der Begriff der Willensfreiheit*³, e cila është si udhërrëfyes dhe jep zgjidhje për të dalë nga situatat e izoluara. Me atë që ai edhe në fund nuk e zbaton arratisjen do të thotë se dezertimi i tij sipërfaqësisht duket të jetë i dështuar.

2.2 WINTERSPELT

Romani *Winterspelt*⁴ është një ndër veprat më të njohura të tij ku autorë rrëfen për një rreshtë të lartë me emrin Dincklage të ushtrisë naziste, i cili meqë ishte kritik ndaj regjimit gjithashtu planifikonte pak para përfundimit të luftës që t'ia dorëzonte batalionin e tij forcave amerikane. Në fillim ideja e tij sado që dukej abstrakte, por nga momenti kur Dicklage u dashurua në një vajzë të re, papritmas krijuhet mundësia që një gjë e tillë të bëhet realitet. Vajza e quajtur Käthe posedonte lidhje të mira me ushtarët amerikanë ashtu që i ofrohet mundësia që të organizojë dorëzimin e batalionit gjerman. Në këtë rast Käthe nuk vepron pa interes. Ajo shpreson që së bashku me batalionin edhe ajo gjithashtu të mund të dezertohej nga Gjermania. Por plani dështon në mosgatishmërinë e amerikanëve, mbasë ata si nga fakti që nuk duan të rrezikojnë një zhvillim të tillë të luftës ashtu edhe nga fakti i pavendosmërisë të rreshterit të lartë Dincklage.⁵

Çfarë mund të vërejmë në lidhje me motivin e dezertimit, është se amerikanët më pak i përkushtohen planit të dezertimit të gjermanëve se vetë gjermanët. Nga kjo rrjedh se arratisjet ndodhin vetëm nga situata jo vullnetare. Kundrejt figurave që vuanin nga diktatura si Dincklage dhe Kathe, amerikanen duken më të balancuar dhe sovran.

2.3 FAHRERFLUÇHT (HÖRSPIEL)

Para emigrimit për në Berzona 1957⁶ Andersch punon në projekte të ndryshme në radio stacione dhe nga përvoja e fituar më 1965 ja arin të transmetojë veprën e tij të famshme *Fahrerflucht (Hörspiel)*⁷. Në formën më të mirë akustike Andersch paraqet arratisjen e dështuar të një drejtori të përgjithshëm, i cili vuan nga një sëmundje të pashërueshme. Në një mëngjes kur ai niset me veturën e tij në udhëtim për të

¹Krh. Andersch, Alfred (2003): *Sansibar oder der letzte Grund*. St. Gallen. F. 3-12.

Në: <http://www.romanlooser.ch/Façharbeit/FaçharbeitBeispiel.pdf>. Online 14.02.2017

²Krh. Camus, Albert (1963): *Der treibende Stein*, in: *Das Exil und das Reich*. Reinbek 1963. F. 31-35.

³Krh. Cramer, Konrad (Hg) (1990): *Theorie der Subjektivität*. Frankfurt a. M. S. 384.

⁴Andersch, Alfred (1974): *Winterspelt*. Zürich.

⁵Krh. Andersch, Alfred: *Winterspelt*. Në: www.gbv.de/dms/faz-rez/741008_FAZ_0031_1L_0001.pdf. Online 16.02.2017.

⁶Krh. Episoden-Hörspielaufzeichnung von Alfred Andersch: "Fahrerflucht". Në: www.phonostar.de/radio/episoden-hoerspielaufzeichnung-alfred-andersch-fahrerflucht/v/88519/2013-03-23. Online 16.02.2017.

⁷Andersch, Alfred (1986): *Fahrerflucht (Hörspiel)*. Stuttgart.

shijuar edhe gjysmën e vitit të fundit të jetës që i ka ngelur papritmas i ndodh një aksident automobilistik. Meqë aty ai e lëndon një vajzë për vdekje detyrohet të arratiset. Shitësja e re ishte nisur që të takoj një djalë kinez, i cili duhej ta mësonte atë të kalërojë. I vetmi dëshmitar ndërmjet policisë dhe drejtorit në arratisje ishte shërbyesi i pompës benzinës, të çilin drejtori i përgjithshëm e frikëson dhe korrupton. Shërbyesi ankohet mbi autoritetin imponues të njerëzve të tillë dhe e krahason atë me rreshterin e frontit të Italisë. Mbështetësi shërbyesi kishte frikë që nga lindja kishte qenë edhe rreshteri autoritar me një karakter arrogant si drejtori. Deri në fund ngel pikëpyetje për shërbyesin nëse duhet të paraqesë rastin në polici ose jo.¹

Në fakt vepra *Fahrerflucht / Arratisja e vozitësit* është një vepër tragjikë, pasi që të tre përpjekjet për arratisje janë të dështuara. Së pari arratisja e drejtorit të përgjithshëm nga jeta e tij e bezdisur që i përfundon brenda gjysmë viti, ndjenja e fajt si dhe frika për tu arrestuar. Më pas edhe shërbyesi gjatë gjithë tregimit nuk arin të arratiset nga faji që e mbart me vete dhe paraqitjen e rastit të aksidentit në polici. Së fundi dezertimi përfundon me klithjen e vajzës në rastësinë ku ajo përplaset me veturën e drejtorit.

Rastësia si fenomen duket të ketë rëndësi të veçantë për Alfred Andersch-in, pasi që ai jo vetëm në romanin e tij „Efraim“² shpreh nëpërmjet personazhit kryesor besimin e tij ndaj rastësisë së botës por edhe në veprën „Sansibar oder der letzte Grund“ ai shpreh gjithashtu nëpërmjet komunistit Gregor çështjen ndaj rolit të rastësisë.³ Në përpjekjet e autorit që të arratiset nga komunizmi, ai vë në dukje se Perëndia është rastësi më e mirë se partia, e cila njeh vetëm ligjet.

2. 4 DIE KIRSCHEN DER FREIHEIT

Në romanin *Die Kirschen der Freiheit* autori përshkruan jetën e tij deri në kohën kur edhe arratiset në Itali ku dhe aq bukur e shtjellon në librin e tij:

*In der Mulde des jenseitigen Talhangs fand ich einen wilden Kirschbaum. [...] Ich taufte meine Kirschen: [...] die Deserteurs-Kirschen, die eilden Wüstenkirschen meiner Freiheit. [...] Sie schmeckten frisch und herb.*⁴

Meqenëse kjo vepër bazohet në karakterin autobiografik, këtu nuk do të shtjelloj motivin e arratisjes, por atë do e trajtoj në kapitullin në vijim.

3. NDERI I DERZERTORIT

Autori si tregimtar ose rrëfyes është plotësish i vetëdijshëm për rrezikun që ai si dezertor ndërmerr. Nuk është lënë asnjë dyshim në tekst, se kur të arratisurit kapeshin nga policia dhe menjëherë janë ekzekutuar. Kjo rrëthanë ishte e njobur te të gjithë ushtarët

*Auf meiner Karte trug das Gebiet die Bezeichnung 'Campagna diserta'. 'Diserta', dachte ich, der gleiche Wortstamm wie 'desert', die wüste also das richtige Gebiet für Deserteure. Deserteure sind Leute, die sich selbst in die Wüste schicken. / Në hartën time vendi mbante shenjën 'Campagna diserta'. 'Diserta' mendoja unë njëjtë si edhe fjala 'desert', që shkretëtira është vend i përshtatshëm për të arratisurit. Të arratisurit janë njerëz, të cilët vetveti shkojnë në shkretëtirë.*⁵

¹Krh. Ein Unfall, drei Säcksale: "Fahrerflucht" von Alfred Andersch. Në: www.phonostar.de/radio/ein-unfall-drei-säcksale-fahrerflucht-von-alfred-andersch/v/100171/2014-02-01. Online 18.02.2017.

²Andersch, Alfred (1967): Efraim. Zürich.

³Krh. Andersch, Alfred (2003): Sansibar oder der letzte Grund. St. Gallen. F. 130-131.

⁴Andersch, Alfred (): Die Kirsche der Freiheit. Zürich. F 130.

⁵ Po aty. F. 128.

Ai përpinqet të pasqyroj maturinë e tij me gjithë rreziqet që mbart ky veprim i arratisjes dhe pikëpamjet tmerruese propagandistike të fatit të arratisurve duke kundërshtuar mendimin se të arratisurit ishin frikacak. Mund të thuhet si jo frikë nga vdekja por që dëshira për të jetuar ishin arsyja për tu arratisur. *Nderin e ushtarit* autor i zëvendëson me *nderin e të arratisurit*, i cili mëre parasysh, që vdekja e tyre të mos jetë e pakuptimtë. Në lidhje me arratisjen e tij parashtron këtë mos përputhshmëri si vijon:

Niemals hätte ich den Mut zur Flucht aufgebracht, wenn ich nicht im gleichen Masse, in dem ich mutig war, feige gewesen wäre. / Unë kurrë nuk do të kisha guximin për tu arratisur, në qoftëse unë nuk do isha frikacak, në të cilën isha i guximshëm.¹

Guximi dhe frika, arsyja dhe pasioni që krijojnë fushën e konfliktit janë elementet të cilat pa dyshim përbejnë thelbin e qenies dhe karakterit të çdo njeriu. Deri sa nuk ulen shtizat dhe dikush nuk ka idenë për liri, këtu qëndron sipas Andersch-it energjia e dëshiruar e individuale².

Andersch nuk do që të mësojë por si duket të provokojë. Ai vendimin e tij individual e hedh për diskutim pa kërkuar që ta zgjedh vetë rrugën përfundimtare:

Ich werde es hoffentlich stets ablehnen, Menschen überzeugen zu wollen. Man kann nur versuchen, ihnen die Möglichkeit zu zeigen, aus denen sie wählen können. Schon das ist anmassend genug, denn wer kennt die Möglichkeit, die der andere hat? (...) Mein Buch hat lediglich die Aufgabe, darzustellen, dass ich, einem unsichtbaren Kurs folgend, in einem bestimmten Augenblick die Tat gewählt habe, die meinem Leben Sinn verlieh und von da an zur Achse wurde, um die sich das Rad meines Seins dreht. / Unë do të rrefuzoj me shpresë, që të dua ti bind njerëzit. Njeriu mund vetëm të përpinqet, atyre tu tregoje mundësinë, nga e çila mund të zgjedhin. Edhe kjo është mjafqueshëm, meqë kush e di mundësinë që tjetri e ka? (...) Libri im ka vetëm për detyrë, që të paraqesë, se unë, ndjek një kurs të padukshëm, në një situatë të çaktuar ngjarjen kam zgjedhur, të cilat jetës sime i dhurojnë kuptim dhe u bë bosht, rreth së cilës rrota e të qenurit sime rrrotullohet.³

Ky momenti i kundërshtimit duhet të gjej zbatim nëpërmjet një procesi produktiv të interpretimit. Fakti që mundimi dhe arti nuk janë patjetër rrugë e kënaqur, në tregimin *Die Kirschen der Freiheit* përkufizimi dhe vëtmia në rininë e Andersch-it janë rrjedhojë e një tërheqje në botën e tij dhe në estetikë.

Në veprën autobiografike *Kirschen der Freiheit* Alfred Andersch-i e shqyrton rrënjosht çështjen e ushtarit gjerman, i cili për arsy të nederit që ka, para uniformës i reziston përpjekjeve të aleancës që ishin kundër nazizmit dhe për ndryshime politike: *an der Kameradschaft und dem Eid / në shoqërinë dhe betimin.*⁴ Autori mohon shoqërinë dhe promovon betimin përmes radio kanaleve. Ai e përshkruan pamjen e Hitlerit si të zbehtë dhe të nevrikosur dhe qëndron pas këtij qëndrimi. Andersch duhet këto detyrime ushtarake ti shpall të pavlefshme, për të paraqitur veten dhe arratisjen e tij para lexuesve jo vetëm si të kuptueshme, por për të paraqitur atë si të vetmen alternativë. Mendoj se ky është qëllimi i vetëm në veprën e tij dhe e përshkruan si vijon: *Mein Buch hat nur eine Aufgabe - einen einzigen Augenblick der Freiheit zu beschreiben / Libri im ka vetëm një detyrë - për të përshkruar momentin e vetëm të lirisë⁵.* Ky është momenti i arratisjes, të cilën ai e pasqyron si formë e plotkuptimtë. Kundër ose për këtë qëndrim autor i rikthen një definicion të ri sa i përket nederit, *Nderit të arratisjes*:

Die meisten Desertionen, besonders die geplanten Massendesertionen, etwa der italienischen Soldaten in Afrika, geschahen nicht aus Furcht vor dem Tode, sondern aus dem Willen, zu leben. So wie die meisten

¹ Po aty. F. 90.

²Krh. Po aty. F. 84.

³ Po aty. F. 71.

⁴Krh. Der Spiegel. Në: <http://www.spiegel.de/spiegel/print/d-21978086.html>. Online 05.03.2017.

⁵ Der Spiegel. Në: <http://www.spiegel.de/spiegel/print/d-21978086.html>. Online 05.03.2017.

*Selbstmorde nicht aus Angst vor dem Leben, sondern aus dem Wunsch zu sterben entstehen. Ich meine, daß man sich nur töten kann, wenn man von unwiderstehlicher Liebe zum Tode erfaßt ist / Arratisjet e shumta respektivisht arratisjet e planifikuara tē ushtarëve italianë nē Afrikë nuk ndodhën nga frika para vdekjes, por nga vullneti pér tē jetuar. Ashtu si shumiça e vetëvrasjeve jo nga frika pér tē jetuar, por nga dëshira pér tē vdekur. Unë mendoj se njeriu mund vetëm tē vrasë, kur njeriu eshtë kapur nga dashuria që nuk rezistohet pér nē vdekte.*¹

Ai që vendos tē shkojë nē betejë ku dhe mund tē vdes, duhet tē ketë vendosur pér tē vdekur, sepse ai nuk mund tē llogaris se do tē mbetet i gjallë. Ai mund tē llogaritet si një vetëvrasës potencial, dhe këtu nuk e kam fjalën pér njerëzit që nuk dallojnë shumë nga kafshët e egra vrastare dhe nisen nē luftë pér tē vrarë. Nga vetë fakti që njeriu niset nē betejë ai edhe e sheh vdekjen nē sy dhe kjo mund tē jetë nē një lloj forme edhe nderi i një luftëtari. Kurse nderi i tē arratisurit dallon nē pikpamjen e vdekjes nga ajo që përmendem sipër, pér arsy se autori e quan nder kur ushtari arratiset. Autobiografi Andersch edhe vetë eshtë mbrojtur kundër kritikave pér tē justifikuar veprimin e tij nga një pikpamje tjeter: *Und ausserdem wollte ich natürlich rüber, weil ich Angst hatte, ins Feuer zu kommen und, sinnlos oder nicht sinnlos, sterben zu müssen / Dhe natyrish doja andej, sepse kisha frike tē futem nē zjarr dhe tē vdes me domethënie ose pa domethënie.* Por problemi i tij kryesor qëndron nē: *Für mich gab es kein Schützenloch, aus dem heraus ich hätte feuern können / Pér mua nuk kishte një strofull, nga ku unë do tē kisha gjuajtur.*² Fuqia e librit eshtë pothuasje përkufizimi ndikues mbi egon e autorit respektivisht *vetja*, fuqi e çila paraqet një kombinim tē rrallë mes rrëfimit autobiografik, kritikës kaustike dhe mediatimit së lirisë egzistenciale. Andersch përshkruan nē përbajtje librit figurën si një tē ri ideal që korrespondon me tē huajën dhe individualen. Bashkim vllazërimi pér autorin eshtë i vdekur që nga momenti kur ai e përshkruan dorëheqjen e tij nga partia pas një kritike tē ashpér ndaj dështimit tē komunizmit pér ta liruar nga kampi i përqëndrimit nē Dachau. Kjo i dhuron librit tē tij një profil tē mprehtë dhe ai fiton lëvdata tē shumta pér krijimtarinë e tij letrare nga kolegët e grupit 47. Vetëm me egocentrizmin e tij tē vetëdijshëm eshtë fama e tij e mundshme dhe e besueshme. Dhe e vtmja mënyrë që ai tē arrijë një efekt dhe që drejtorit editorial tē quajtur Marek, i cili nuk eshtë sentimental, ti drejtojë vërejtjet e tij: *Man müßte eigentlich an Hand dieses Buches einen neuen Ausdruck für eine neue Gattung der Literatur finden / Në fakt nē bazë tē këtij libri njeriu duhej tē gjejë një shprehje tē re pér një zhanr letrar tē ri.*³ Por sikur tē qëndronte mendimi, se vetëm nga pjesëmarrësit e rind dhe veteranët e luftës përbëhet libri dhe ata nuk do tē kishin rënë pre e nazizmit, atëherë libri do tē fitonte vlefshmëri tē gjerë nëpërmjet tē individualiteti tē tij ekstrem. Karriera individuale e autorit nē asnjë mënyrë nuk eshtë aspak e pazakontë. Nga ndikimi i babait tē tij nationalist dhe gjendja mjeruese e familjes së tij ai bëhet komunist i ri dhe shpejt avancohet si funksionar i ri.

Kthesa dhe rënia fatale e tē majtës bashkangjitur edhe disa muaj nē qendrën e përqëndrimit nē Dachau e transformuan atë deri nē atë masë sa që mund tē vërejm nē tekst: *Ich antwortete auf den totalen Staat mit einer totalen Introversion / Unë i përgjigjesha shtetit totalitar me një introvertë totalitare.*⁴ Nga momenti i invazonit nē vitin 1944 kur ai nē një vend tē vogël i hedh armët dhe ikën, fillon jeta e tij tē marr drejtimin e lirisë. Para se ai tē filloj tē përshkruaj çlirim e tij, ai vendosi disa mina këmbësorësh dhe pér këtë akt ai mund edhe tē kritikohet. As penda dhe as pushteti nuk do tē luftojnë por miliona njerëz tē guximshëm, edhe pse tē luftosh ishte e pakuptimtë. Në qoftë se ata luftonin dhe shpesh e bënin mirë, e

¹ Po aty.

² Po aty.

³ Po aty.

⁴ Po aty.

bënин нён presion ose pér tu treguar tē dinjitethëm dhe besnik, sepse duhej dalë faqebardhë ose kur idiotët kishin fituar betejën kundër tjerëve dhe kërkonin që tē dozëroheshin pa kushte:

Die deutschen Soldaten haben das Gesicht gewahrt. Aber es hat im letzten Krieg niemals eine Wehrmacht gegeben, sondern einzig und allein Millionen bewaffneter Männer, deren größter Teil nicht die geringste Lust hatte zu kämpfen / Ushtarët gjermanë dolën faqebardhe. Por në luftën e fundit nuk ka pasur asnjëherë shërbim ushtarak, por vetëm miliona njerëz tē armatosur, shumica e tē cilëve nuk kishin as dëshirën më tē vogël pér tē luftuar¹.

Nga kjo mund tē duket sikur autori ka krijuar akuza ekstreme subjektive dhe tē ekzagjeruar, me qëllim që tē nxisë dhe pér tē provokuar kundërshtarët e tij. Betimin ai e quan si die letzte Ausflucht / Braktisja e fundit dhe ushtarët gjermanë këtë rrugë do ta ndjekin me tē drejtë më vonë:

Ich gebe zu, daß für viele Offiziere der Eid ein Problem darstellte. Aber ich habe während des ganzen Krieges unter den Mannschaften, bei denen ich mich befand, keinen einzigen Soldaten getroffen, der jemals ein Wort über den Eid verloren hätte / Unë e pranoj se pér shumë oficerë betimi paraqiste një problem. Por unë gjatë gjithë luftës nuk kam takuar asnjë ushtarë ndër trupin ushtarak ku edhe unë bëja pjesë, tē cilët do tē kishin thënë ndonjëherëndonjë fjala në lidhje me betimin.²

Sipas Andersch-in betimi ushtarak nën komandon e Hitlerit ishte realizuar pa e menduar fare dhe thjeshtë si një absurditet. Kushdo që do tē ishte nën komandën e nazistëve dhe do tē mohonte tē ndiqte urdhrat e eprorëve ai ose do ishte vrarë ose do tē dërgohej pér disa vite në një kamp përqendrimi. As autori nuk ka vepruar ndryshe deri ne momentin kur i erdhi rasti tē arratiset. Andersh-i këtë e përshkruan: *Der Eid wurde also unter Zwang geleistet. Auf seine Verweigerung stand der Tod. Er war damit null und nichtig / Betimi eshtë bërë nën presion. Pas refuzimit të tij qëndronte vdekja. Pra ai ishte asgjë dhe i pavlefshëm.* Pér më tepër ai mendon se betimi eshtë një akt fetar dhe vetem besimtari eshtë i aftë pér tē dhënë betimin: *Aus diesem Grunde war die Mehrheit der deutschen Soldaten nicht eidesfähig. Nicht eidesfähig war ferner ihr Führer .. / Pér këtë arsyе shumica e ushtarëve gjermanë nuk ishin tē aftë pér tē dhënë betimin. As edhe udhëheqësi i tyre nuk ishte i aftë pér betim ...³*. Në thelbin e këtij kapitulli tē librit tē tij autori tekalon përfundimisht kornizat autobiografike dhe vjen më përfundime tē përgjithshme logjike si akti religioz i betimit, oborret e kazermave, absurditeti i detyrimit ushtarak dhe i luftës etj. Prandaj autori ka bindjen se ushtria në tē ardhmen duhet tē jetë vetem një ushtri vullnetare: *Nach der Lage zu urteilen, in der sich der Glaube heute befindet, ist der Eid in einer solchen Armee nicht mehr denkbar / Duke gjykuar simbas situatës në tē cilën sot gjendet besimi, betimi nuk tē paramendohet në një ushti tē këtillë.* Dhe ai vazhdon me vizionin e tij më tej: *Eine solche Freiwilligenarmee wird riesig sein, ... / Një ushtri e këtillë vullnetare do tē jetë e madhe,* Alfred Andersch nuk zbulon nëse këto fjali i drejtohen përgjegjësit pér çështje sigurie Theodor Balnk ose jo. Ai nuk diskuton aspak paraprakisht: *Was ich zu sagen habe, steht drin. Ich hoffe, ich habe es konkret genug gesagt. Jetzt sind die anderen dran / Atë që kam pér tē thënë, eshtë brenda. Unë shpresoj e kam thënë mjaftueshëm konkret. Tani janë tē tjerët në radhë.⁴* Die Kirschen der Freiheit mbaron pikërisht me momentin kur ai arrestohet. Ai mbërrin fshatin ku ai takon italianët civilë duke festuar. Duke analizuar tekstin e tij në die *Ehre des Deserteurs* mund tē thuhet se ai i referohet pozicionit tē provokuesit brenda një horizonti tē ndarë. Ai hap një debat pér tē interpretuar konskuencën kulturore nga përvoja e përjetuar gjatë luftës së dytë botërore dhe shkruan protokoll pér largimin e tij nga kolektivi ushtarak, tē cilës ai ishte i detyruar ta ndjekë. Ai largohet nga ushtria por jo edhe nga çdo

¹ Po aty.

² Po aty.

³ Po aty.

⁴ Po aty.

pjesëmarrje. Ai vazhdon të provokojë përsëri në mes të një debati për riarmatosje dhe me rrëfimin e tij dëshironte që me platformën antiushtarake të delegitimojë idealet ushtarake me fjalët e përdorura në tekstin si *Kameradenschaft und Fahnenfeind / Shoqëria dhe betimi për flamur*. Kontributi në diskursin e riarmatimit dhe përvoja nga lufta e dytë botërore janë njëherë vetëm performative. Edhe pse autorit është një individualist padyshim se përcjellja e arratisjes dhe nderit është një inovacion kulturor dhe letrar. Nga e gjitha që përpiluan mund të themi se *Die Kirschen der Freiheit* i takon një kontributi të krijimtarisë letrare të terminuar në aspekt kohor dhe historik. Po të fokusohemi në vlerësimin e arratisjes nga ushtria rezulton se vepra e Andersch-it është një fillim historik dhe përfundon me tendencë për njohjen e problematikës së arratisjes nga ushtria si një rezistencë legitime. Parakusht për këtë është ndër tjerash debati i ashpër mbi prezantimet e ushtrisë pranë institutit për hulumtime sociale në Hamburg dhe gjetja e një koncenzusi, që lufta e udhëhequr dhe e shkaktuar së paku të klasifikohet si krim.¹ Si përfundim mund të supozohet se këto informacione historike nga krijimtaria letrare e autorit kanë një rezonancë të gjërë. Më tej mund të thuhet se po të ishtejeta e Andersch-it ndryshe atëherë nuk do të kishim këto tekste autobiografike autentike që përshkruajnë ngjarjet drejtpërsëdrejti nga autorit. Sot shumë vite pas përfundimit të luftës thelbësisht ka ndryshuar situata. Ndoshta duhet të pranojmë, se kontributin letrar, autentik dhe historik nuk mund ta kthejmë mbrapsht. Kjo do të ngelë një pasuri letrare historike dhe pa kontributin e Andersch-it nga pikëpamja e autenticitetit ndoshta do të ndjehej një zbrazëtirë dhe mungesë e madhe letrare. Kontributi i Andersch-it është dhe do të mbetet i pakundërshtueshëm jo vetëm në Gjermani por edhe më gjërë.

4. PËRFUNDIME

Andersch me krijimtarinë letrare të tij ka arritur zhvillimin kulminant letrar. Fillimi i tij si një redaktor inteligjent dhe me ndikim të madh tanimë është shumë i famshëm edhe në krijimtarinë letrare, me një autoritet moral jo vetëm në Gjermani por edhe më gjërë. Për të kuptuar influencën krijuese letrare dhe rëndësinë e tregimit autobiografik të Alfred Andersch-it duhet që lexuesi nëpërmjet të këtij punimi të kuptoj motivin shumë dimensional të arratisjes si element kyç në veprën e tij. Qëndrimi i tij ndaj arratisjes paraqet nga njëra anë konskuencën e fundit pas një kohe të gjatë të presionit psikologjik, përpjekjen dhe tentimet për arratisje. Në anën tjetër në shikohet prapa dhe defionohet qartë si një vendim politik. Gjithashtu mund të thuhet se në pikëpamje filozofike vendimi i tij për arratisje shihet si një perspektivë, e cila në kontekstini e sotëm të vlerësimit të arratisjes dhe të të arratisurve na ofron pikëpamje dhe argumente të rëndësishme. Ky punim shpresoj të jetë për shumë lexues një nxitje për të lexuar dhe njohur si veprat e krijuesit të famshëm poashtu edhe autorin me një influencë të madhe letrare Alfred Andersch, i cili me përshkrin e arratisjes si akt i lirisë, mendoj se lexuesit do të zgjerojnë dhe pasurojnë hapësirën e tyre letrare dhe pse jo ndoshta mund të jetë si ndihmesë për të gjetur lirinë individuale në një këndvështrim personal. Rrëfimi autobiografik dhe autentik i Andersch-it fillon me një përshkrim të një fëmijërie që I përkiste një klase të ulët shoqërore dhe përfundon me një arratisje gjatë luftës së dytë botërore. Gjatë kësaj periudhe Anderschi i ri kalon nëpër fazën e ndryshme të pjekurisë politike. Si anëtarë i shoqatës rinisë komuniste ai arrestohet dhe depërtohet në Dachau. Që prej lirimit të tij dhe arrestimit për së dyti ai traumatizohet nga politika dhe fillon me të ashtuquajturën emigrim i brendshëm shpirtëror. Në vitin 1940 ai thirret t'i shërbej ushtrisë, ku katër vite më vonë ai vendos të arratiset dhe ky është elementi dhe zhvillimi qendror në tregimin e tij autobiografik. Tema e lirisë individuale është trajtuar në shumë pjesë të librit të tij dhe arrin kulminacionin më mendimet e tij rreth arratisjes. Sipas Andersch-it shumë

¹Krh. Ächtler, Norman Hg. (2016): Alfred Andersch. Engagierter Autorschaft im Literatursystem der Bundesrepublik. Gissen. F. 84-85

pak njerëzve i'u është lejuar të ndjejnë momentin e lirisë dhe për të vepruar në përputhje me rrethanat gjegjësisht atë ta gëzojnë. Në momentin kur ai vendosi që të largohet nga shërbimi ushtaraku atëherë e pa veten në grupin e njerëzve që e ndjejnë lirinë. Justifikimi dhe stili i tij si subjekt i përgjedhur letrar i bën që shumë lexues të jenë kritik dhe të mendojnë se si qershitë e tharta nuk mund të shijojnë edhe aq! Megjithatë është një libër shumë i rendësishëm mbi lirinë individuale edhe në kushte diktoriale.

Letërsia e pasluftës dhe arti në Gjermani padyshim që gëzojnë një vlerësim ndërkombëtar, por që nuk i prekë ata autorë, të cilët ishin ulur dhe janë ulur pranë qendrave të kontrolluara, të cilët vetveten e përshkruajnë si elitë, por vlerësojnë autorët si Alfred Andersch, të cilët menjëherë pas vitit 1945 filluan të shkruajnë. Ai ka qenë në gjendje të zhvillojë dhe përdorë mënyrat adekuate të krijimit. Ai e kuptoi shumë mirë që në fillim se teknikat tradicionale të krijimtarisë letrarë, të cilat përdoreshin ishin të papërshtatshme dhe jo të mjaftueshme për të përshkruajtur në formë të drejtë dhe sa më transparente. Andaj mendoj se ne si lexues duhet të kemi krenari dhe dashuri ndaj librave dhe pikëllimi për mungesën e tij. Alfred Andresch ka kontribuar jo vetëm për gjermaninë por për gjithë botën.

5. LITERATURA

Ächtler, Norman Hg. (2016): Alfred Andersch. Engagierter Autorschaft im Literatursystem der Bundesrepublik. Gissen.

Andersch, Alfred (1952): Die Kirschen der Freiheit. Zürich.

Andersch, Alfred (1957): Sansibar oder der letzte Grund. Olten.

Andersch, Alfred (1967): Efraim. Zürich.

Andersch, Alfred (1970): Sansibar oder der letzte Grund. Zürich

Andersch, Alfred (1974): Winterspelt. Zürich.

Andersch, Alfred (1986): Fahrerflucht (Hörspiel). Stuttgart.

Koppermann, Ulrike (2013): Bachelorarbeit: Zu Engagement und ergangenheitsverdrängung in Alfred Anderschs Literaturprogramm und seinem Roman Die Rote. Potsdam.

Schön, Karl (2013): Alfred Andersch und seine Zeitschrift „Texte und Zeichen“. München.

Camus, Albert (1963): Der treibende Stein, in: Das Exil und das Reich. Reinbek.

Cramer, Konrad (Hg) (1990): Theorie der Subjektivität. Frankfurt a. M.

https://de.wikipedia.org/wiki/Alfred_Andersch.

<http://www.zeit.de/2011/20/Max-Frisch-Berzona>

<http://www.studentshelp.de/p/referate/02/6482.htm>

<http://www.schultreff.de/biographien/b0005t00.htm>

<http://www.romanlooser.ch/Façharbeit/FaçharbeitBeispiel.pdf>

http://www.gbv.de/dms/faz-rez/741008_FAZ_0031_1L_0001.pdf

<http://www.phonostar.de/radio/episoden-hoerspiel-drama-von-alfred-andersch-fahrerflucht/v/88519/2013-03-23>.

<http://www.phonostar.de/radio/ein-unfall-drei-schicksale-fahrerflucht-von-alfred-andersch/v/100171/2014-02-01>.

<http://www.spiegel.de/spiegel/print/d-21978086.html>.